VENDIM
Nr. 143, datë 7.7.2025

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "HYDROPOWER" SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, *"Për sektorin e energjisë elektrike",* i ndryshuar; nenit 64, të ligjit nr. 44/2015, *"Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*, si dhe nenit 15 të "*Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s"*, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1589/10 prot., datë 1.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Hydropower' sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të paluajtshme të saj",

Konstatoi se:

- Shoqëria "Hydropower" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhimi 2 *mw*, në Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 307, datë 30.11.2022.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1589 prot., datë 23.4.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të shoqërisë "Hydropower" sh.p.k., në favor të "Raiffeisen Bank" sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 101, datë 12.5.2025, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Hydropower" sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1589/3 prot., datë 14.5.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim. ERE nëpërmjet shkresës nr. 1566 prot., datë 16.4.2025, ka njoftuar gjithashtu edhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për këtë vendimmarrje.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1589/4 prot., datë 28.5.2025, depozitoi një pjesë të dokumentacionit/informacionit të kërkuar nga ERE, nga analizimi i të cilit u konstatua mungesa e listës së detajuar të aseteve fikse me vlerat përkatëse (pasi lista e përcjellë nuk kishte vlera). Ndaj ERE, me shkresën nr. 1589/5 prot., datë 11.6.2025, i kërkoi shoqërisë depozitimin e sa më sipër, si dhe duke i risjellë në vëmendje se ERE shprehet vetëm nëse vlera totale e tyre është më e madhe se 150,000,000 lekë.

- Shoqëria nëpërmjet shkresës me nr. 1589/6 prot., datë 18.6.2025, ka shprehur se janë të paqartë mbi sa kërkuar nga ERE, ndaj kërkojnë një takim sqarues në lidhje me këtë aplikim. Si e tillë, nga ana e ERE-s, u vlerësua mbajtja e një seance dëgjimore për të cilën është njoftuar shoqëria nëpërmjet shkresës dhe *e-mail*-it respektiv, dhe në vijim seanca u mbajt në datën 23.6.2025.

- Gjatë seancës shoqëria sqaroi se do të saktësonte listën e aseteve fikse me vlerat përkatëse të tyre, e në rast se vlera do jetë nën 150,000,000 lekë, atëherë shoqëria do të kërkonte përfundimin e procedurës, por në të kundërt do të përcillte dokumentacionin e munguar.

- Së fundi, me shkresën nr. 1589/9 prot., datë 26.6.2025, shoqëria kërkoi ndërprerjen e procedurës së marrjes së autorizimit nga ERE duke qenë se nuk përmbushet kushti që vlera e aseteve të jetë më e madhe se 150,000,000 lekë, siç është përcaktuar në rregulloren në fuqi.

- Neni 64, pika 2, i ligjit 45/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", parashikon se, *një palë, me anë të një kërkese me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative*.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 12.5.2025, "Mbi fillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë "Hydropower" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj".

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Hydropower" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti